



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 16/11

Prishtinë, më 21.06.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa, Duda Balje dhe Albana Fetoshi.

Munguan: Naser Osmani dhe Xhevdet Neziraj

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Ramadan Avdiu-Zëvendësministër i Financave, Lulzim Rafuna-MF, Alexander Beetz, Ramadan Islami, Benazir Alsanova dhe Teki Shala-GIZ, Isuf Zejna-KDI dhe Sanije Berisha-OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social me raportin me amendamente të komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal me partneritete, me raportin me amendamente të komisionit funksional për Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
- 4. Miratimi i propozim-amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi që pika e katërt të ndryshohet si në vijim: Shqyrtimi i Projektligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ndal palëve të treta.

Rendi i ditës miratohet, me ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social me raportin me amendamente të komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Projektligji e ka pasur një kosto jo të madhe buxhetore, e cila është e përfshirë edhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Nga raporti shihet që amendamentet nuk kanë implikime buxhetore dhe komisioni një zëri nxorri këtë:

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal me partneritete, me raportin me amendamente të komisionit funksional për Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetarja, konsideroi që projektligji në përgjithësi dhe amendamentet nuk kanë implikime buxhetore.

Albana Fetoshi, e konsideroi projektligjin si njërin prej projektligjeve më të këqija që ka ardhur deri më tash në Kuvendin e Kosovës, për shkak se parasheh themelimin e trupit të përbashkët administrativ të komunave, themelimin e ndërmarrjeve të përbashkëta publike dhe institucionet e përbashkëta publike. Kjo do të thotë që po krijohet një shtet i ri brenda shtetit të Kosovës, sepse komunat shqiptare nuk kanë nevojë të kenë bashkëpunim ndërkomunal, përderisa i kanë institucionet e veta. Ky projektligj është bërë për shkak të komunave me shumicë serbe, në mënyrë që ato të bashkëpunojnë në mes veti.

Kryetarja, sqaroi që Komisioni për Buxhet dhe Financa shqyrton vetëm anën financiare të amendamenteve, ndërsa çështjen juridike e shqyrton Komisioni për Legjislacion. Shqetësimet që i ngriti parafolësja është dashur të shqyrtohen në seancë plenare në lexim të parë.

Komisioni me gjashtë vota pro (Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj dhe Muhamet Mustafa), një kundër (Albana Fetoshi) dhe një abstenim (Hykmete Bajrami), nxorri këtë:

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë

4. Miratimi i propozim-amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ndaj palëve të treta

Muhamet Mustafa, shprehu vërejtje në amendamentin 4 te përkufizimi 1.22, 1.23 dhe 1.24 për nocionet “autopërgjegjësia” dhe “nënkupton”, duke përmendur që “autopërgjegjësia” në një farë mënyre mund të kuptohet edhe si “vetpërgjegjësi”.

Latif Gashi, sqaroi se kompensimi nuk bëhet vetëm ndaj palëve të treta, por bëhet edhe ndaj personit i cili e bart policën apo e nget veturën.

Haxhi Gashi, sqaroi lidhur me termin “autopërgjegjësia”, që nënkupton përgjegjësinë ndaj mjetit motorik apo përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjetit motorik.

Hykmete Bajrami, lidhur me amendamentin 5, neni 3 paragrafi 1, konsideroi që versioni siç ka qenë projektligj është më i mirë se sa ky i ndryshuar nga grupi punues.

Sali Asllanaj, sqaroi se me ndryshimin e bërë është kuptuar që me sigurim hiqet barra nga personi dhe mbulohet nga sigurimi, por jo që dëmet e shkaktuara nga personi përgjegjës në komunikacion është jashtë mbulesës të kompensimit të dëmeve.

Haxhi Gashi, ligji ekskluzivisht merret me mbulimin e përgjegjësisë të personit që e përdor mjetin motorik për dëmet që ia shkakton dikujt tjetër në komunikacion, dmth e mbulon rrezikun për dëmet që tjetrit ia shkakton.

Latif Gashi, theksoi që ligji nuk ka për qëllim që të mbajë vetëm palën e tretë, por njëkohësisht e mbron edhe personin që e bën aksidentin, prandaj është hequr termi “ndaj palëve të treta” në titullin e ligjit.

Amendamenti 7 i propozuar nga deputetja Suzana Novobërdaliu nuk përkrahet nga anëtarët e komisionit.

Latif Gashi, sqaroi lidhur me amendamentin 9, se kompanitë e sigurimit kanë insistuar te BQK-ja që me rastin e ndryshimit të pronarit të mjetit të sigurohet edhe një herë, natyrisht që kjo ka qenë interes i tyre që të realizojnë të hyra më të larta, mirëpo grupi punues i komisionit kanë insistuar që automatikisht me ndërrimin e pronarit të bartet edhe polisa te pronari i ri i mjetit.

Hykmete Bajrami, theksoi lidhur me amendamentin 15 duhet të shikohet sa është e implementueshme kjo në Kosovë si dhe për këtë duhet të ketë edhe dispozita tjera që e rregullojnë këtë fushë.

Latif Gashi, sqaroi që ky nen është bërë me rastin që kur dikush e posedon një polisë me kushte që t’i sigurohet edhe fondi pensional, sigurimet shëndetësore dhe invalidore nga banka dhe kompanitë e sigurimit, varësisht nga përgjegjësitë që përfshihen në kontratë.

Muhamet Mustafa, propozoi që në paragrafin e dytë të shtohet fjala “me kontratë” pas fjalës “të të siguruarit”.

Me shtatë vota pro (Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Latif Gashi, Duda Balje, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj dhe Muhamet Mustafa) dhe dy abstenime (Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi), komisioni miratoi amendamentin 15 me ndryshimin e propozuar nga deputeti Muhamet Mustafa.

Muhamet Mustafa, propozoi që në amendamentin 21 për riformulimin e paragrafit 6, fjala “kamtvonesës” të zëvendësohet me fjalën “interesi për vonesë”.

Komisioni njëzëri miratoi **amendamentin 21** me ndryshimin e propozuar nga deputeti Muhamet Mustafa.

Hykmete Bajrami, propozoi që në amendamentin 23 për riformulimin e paragrafit 6, të hiqen fjalët “vetëm” dhe “ka në disponim”.

Komisioni njëzëri, miratoi amendamentin 23, me ndryshimin e propozuar nga deputetja Hykmete Bajrami.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve konkrete, Komisionit nxorri këtë:

P Ë R F U N D I M

Miratohen propozim-amendamentet e grupit punues, për Projektligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ndaj palëve të treta, me ndryshimet e bëra në Komision dhe i rekomandohet Kuvendit miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara. Raporti me amendamente i bashkangjitet këtij procesverballi.

5. Të ndryshme

Nuk pati ndonjë çështje tjetër për të diskutuar

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadërgjonaj